

VENDIM
Nr.1547, datë 26.11.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE “IDEA
VLORA” SHA, PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PARKUT INDUSTRIAL NË VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, dhe të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe “Idea Vlorë” sha-së, për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e parkut industrial në Vlorë, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha